

Rrëqebulli i Ballkanit jeton ende mes nesh!

Aleksandër Trajçe / Bledi Hoxha

Shoqata për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri (PPNEA)

Të gjithë kemi dëgjuar për vlerat dhe trashëgiminë natyrore të vendit tonë dhe krenohemi me këtë pasuri kombëtare. Pyjet dhe mjediset tona natyrore, edhe pse kanë vuajtur nga shkatërrime të shumta gjatë viteve të fundit, ende mbartin vlera të mëdha nga pikëpamja e biodiversitetit dhe fshehin lloje të rralla dhe endemike në nivel rajonal e global. Rrëqebulli është një nga këto lloje, ndoshta më i rrezikuari nga të gjithë gjitarët e Shqipërisë dhe, pa dyshim, më i veçanti dhe më i mistershmi. Rrëqebulli është felidi më i madh i Europës, me një pamje mjaft karakteristike, me gjatësi 80 – 130 cm, lartësi deri 65 cm dhe me peshë trupore 20 – 30 kilogramë. Popullata e rrëqebullit në Ballkan, nisur nga kërkimet dhe vlerësimet më të fundit shkencore, përbën një popullatë të veçuar nga pikëpamja gjenetike dhe, si e tillë, klasifikohet si nënloj më vete, i njohur në gjuhën shkencore si *Lynx lynx martinoi*.

Vlerësimet më të fundit të ekspertëve tregojnë se numri i rrëqebujve në Shqipëri nuk i kalon 15 - 20 individë gjithsej dhe, si i tillë, është i klasifikuar si një lloj i kërcënuar në mënyrë kritike (CR) në Listën e Kuqe të Florës dhe Faunës së vendit tonë. Gjithësesi, prania e rrëqebullit në Shqipëri nuk ishte faktuar në mënyrë përfundimtare dhe të dhënat për përhapjen e tij deri më sot kanë qenë të bazuara kryesisht në vlerësime teorike.

Nisur nga kjo situatë, Shoqata për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri (PPNEA), në bashkëpunim me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, prej mëse 5 vitesh ka ndërmarrë një program për ruajtjen dhe rimëkëmbjen e rrëqebullit të



RRËQEBULLI I BALLKANIT - FOTO PPNEA

Ballkanit në rajon (www.catsg.org/balkanlynx). Programi ka si synim dhënien e informacionit të saktë dhe të besueshëm për praninë dhe përhapjen e rrëqebullit të Ballkanit në Shqipëri, bazuar në metoda bashkëkohore shkencore, si dhe marrjen e masave konkrete për ruajtjen dhe monitorimin e kësaj popullate. Si rezultat i punës së këtij projekti, më 21 prill 2011, ekipi kërkimor i PPNEA-s nxori foton e parë, në rajonin malor të Shqipërisë veriore, të rrëqebullit të Ballkanit në gjendje të egër, me anë të përdorimit të kamerave-kurth. Individit në fjalë është fotografuar më 26 mars 2011, në orën 18:48. Metodologjia e përdorur nga PPNEA për monitorimin e rrëqebullit në veçanti dhe më gjerësisht për vëzhgimin e gjithë gjitarëve në vend, ka në thelb përdorimin e pajisjeve të quajtura “kamera-kurth”. Kamerat-kurth janë aparate me shkrepje automatike, të pajisura me një sensor i cili dedekton lëvizjen e kafshëve me gjak të ngrohtë dhe i fotografon ato në momentin që kalojnë përpara pajisjes. Këto pajisje montohen në pemë ose kunjat të posaçme të vendosura në pyje, pranë shtigjeve ku njihet lëvizja e kafshëve të egra. Kjo metodë është një metodë jo-invasive për studimin e faunës, pasi gjeneron informacion në lidhje me praninë dhe sasinë e llojeve të ndryshme, pa i shqetësuar ato.

Fotografimi për herë të parë i rrëqebullit të Ballkanit në gjendje të egër është një nga rezultatet më të rëndësishme të arritura deri më tani, pasi provon në mënyrë përfundimtare dhe të pamohueshme praninë e rrëqebullit në Shqipëri. Dokumentimi i pranisë së rrëqebullit në vendin tonë përbën një thirrje të fuqishme për marrjen e masave të menjëhershme për ruajtjen e tyre dhe të habitateve ku ata jetojnë.